



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300415/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** *Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier.*

**Drejtuar:** **Bashkisë Fier**

**FIER**

**Shërbimit Social Shtetëror**

**TIRANË**

**Shtëpisë së të Moshuarve**

**FIER**

*Të nderuar,*

Avokati i Popullit, Ju falenderon për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në institucionin tuaj.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi Shtëpinë e të Moshuarve Fier, më datë 10.05.2023 sipas Planit të Inspektimit për vitin 2023 të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Lindita Dedegjoni dhe z. Besnik Deda, me detyrë ndihmës komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar të institucionit të Avokatit të Popullit.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së këtij shërbimi, ndjekja e rekomandimeve të lëna nga vizitat e mëparshme nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe masat e marra për zbatimin e tyre, mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e të moshuarve, si dhe identifikimin e rasteve të mundshme të përdorimit ndaj

të moshuarve të akomoduar në qendeër të presionit psikologjik dhe përdorimin e forcës fizike tej kufijve në tejkalim të standardeve.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin ligjor, t'Ju parashtrijë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon.

### ***Objektivat e inspektimit:***

- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi,
- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2022 si dhe gjendja aktuale,
- Respektimi i të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë akomoduar në këtë institucion rezidencial, në zbatim të standardeve ligjore, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit,
- Vlerësimi i kushteve infrastrukturore për një trajtim të denjë të këtyre të moshuarve.

### ***Metodologjia***

Grupi i inspektimit i përbërë nga juristë dhe mjek si metodologji pune ka përdorur:

- ***Së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me përgjegjësen e sektorit social, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- ***Së dyti***, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale për të moshuarit.
- ***Së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Shtëpia e të Moshuarve në Fier), ku ofrohen shërbime për personat e moshuar.
- ***Së katërti***, komunikimi me disa të moshuar, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier.
- ***Së pesti***, vlerësimi i dokumentacionit mbi të cilin Shtëpia e të Moshuarve në Fier zhvillon aktivitetin.

### ***Rekomandimet e vitit 2022 dhe niveli i zbatimit të tyre***

Nga inspektimi i mëparshëm i kryer më datë 31.03.2022 në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier, për problemet e konstatuara, Avokati i Popullit ka rekomanduar:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për shtimin e organikës me psikolog, mjek me kohë të plotë dhe kujdestarë.

2. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e vakancës së punonjësit social në institucion.
3. Marrjen e masave për kryerjen e trajnimeve lidhur me zbatimin e standardeve shoqërore për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Fier.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për rivlerësimin e kuotës ditore të ushqimit në vijim edhe të ndryshimeve të fundit në treg.
5. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror ka informuar:

- *Për rekomandimin nr.1.* Për marrjen e masave për shtim në organikë me psikolog, mjek me kohë të plotë dhe kujdestarë, Shërbimi Social Shtetëror sqaron se ka shtuar punonjës me kohë të pjesshme çdo vit në institucionet e përkujdesit social. Bazuar Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 19.01.2022 në Shtëpinë e të Moshuarve Fier është shtuar staf me një Mjek dhe një Sanitare me kohë të pjesshme.
- *Për rekomandimin nr.2* , Për marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e vakancës së punonjësit social në institucion, në shkresën e SHSSH nuk është kthyer përgjigje, por gjatë inspektimit u informuam që është plotësuar vakanca e punonjësit social në institucion.
- *Për rekomandimin nr.3.* Për marrjen e masave për kryerjen e trajnimeve lidhur me zbatimin e standardeve shoqërore për stafin, Shërbimi Social Shtetëror sqaron se në bashkëpunim me organizatat jo fitimprurëse do të planifikojë trajnime të ndryshme të stafeve të IPSH-ve sipas nevojave që ato kanë dhe se në varësi të mbështetjes dhe dakordësisë së OJF-ve për bashkëpunim me SHSSH, specialistët e SHSSH do të vijojnë punën për trajnimin on-job të stafeve sipas programeve të monitorimit për rritjen e cilësisë së shërbimit sipas standardeve.
- *Për rekomandimin nr.4,* Për marrjen e masave të menjëhershme për rivlerësimin e kuotës ditore të ushqimit në vijim edhe të ndryshimeve të fundit në treg, Shërbimi Social Shtetëror sqaron se në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë filluar të bëjnë vlerësimin e kuotës ushqimore për çdo tipologji të IPSH-ve, duke marrë në konsideratë edhe indeksion e çmimeve të tregut. Pas rekomandimeve të Avokatit të Popullit, kuota ushqimore ka ndryshuar në masën 430 leke dhe ka filluar efektet në datë 01.06.2023.
- *Për rekomandimin nr.5,* Për marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës, Shërbimi Social Shtetëror nuk ka kthyer përgjigje.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, rezultoi se janë realizuar vetëm 2 nga rekomandimet e Avokatit të Popullit, ndërsa është realizuar pjesërisht 1 nga rekomandimet, është pranuar, por nuk janë realizuar 1 nga rekomandimet e lëna në

inspektimin e mëparshëm dhe nuk është kthyer përgjigje për 1 nga rekomandimet e lëna:

- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për për shtimin e organikës me psikolog, mjek me kohë të plotë dhe kujdestarë, pasi ishte shtuar një Mjek dhe një Sanitare me kohë të pjesshme.
- Ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin e vakancës së punonjësit social në institucion.
- Është pranuar, por nuk është realizuar rekomandimi për kryerjen e trajnimeve lidhur me zbatimin e standardeve shoqërore për stafin.
- Është zbatuar rekomandimi për rritjen e kuotave ushqimore për të moshuarit.
- Nuk është realizuar rekomandimi për përmirësimin e kushteve infrastrukturore të qendrës. (Ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve Fier në datë 29 nëntor janë përfshirë nga zjarri që ka rënë në banesën që është ngjitur me këtë qendër).

Avokati i Popullit konstaton se nëse disa nga rekomandimet kanë implikime buxhetore, disa të tjera varen nga organizimi i punës dhe vullneti i drejtuesve të institucioneve. Ndërkohë vlerësojmë që institucioni duhet të ketë buxhet të mjaftueshëm për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe ato infrastrukturore. Avokati i Popullit gjen rastin të theksoj se detyrimi për të garantuar të drejtat e njeriut dhe standardet e shërbimit është e parashkruar si në Kushtetutë dhe në ligj.

### **Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit.**

Shtëpia e të Moshuarve në Fier, është një institucion rezidencial dhe ofron shërbime të përkujdesjes për të moshuar në nevojë, të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky institucion është nën administrimin e Bashkisë Fier. Mbështetja financiare është e garantuar nga fondet e buxhetit të shtetit, nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Institucioni është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe raporton për problematika të ndryshme pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Fier.

Shtëpia e të Moshuarve në Fier, ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat e moshuar, të cilët janë të vetmuar apo të braktisur, dhe që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm, sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit.

Organizimi dhe funksionimi i këtij institucioni, së bashku me përshkrimet e punës, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, janë të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të tij<sup>1</sup>, e cila është e afishuar në ambientet e institucionit.

Monitorimi i zbatimit të standardeve të ofruara të shërbimeve sociale, kryhet nga Bashkia Fier, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Instituti i Higjienës dhe Agjencia Kombëtare e Ushqimit.

### **Numri i përfituesve nga shërbimet e ofruara.**

Nga konstatimi paraprak u evidentua se në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier akomodohen dhe ofrohen shërbime për persona të moshuar, mbi moshën 60 vjeç për femra dhe 65 vjeç për meshkuj.

Kapaciteti i institucionit për ofrimin e shërbimeve është për 55 persona të moshuar.

Gjatë inspektimit u evidentua se në këtë institucion trajtohen 53 të moshuar, nga të cilët 18 gra dhe 35 burra. Nga dokumentacioni rezulton se në qendër përfitojnë trajtim 28 të moshuar nga mosha 60-75 vjeç dhe 25 të moshuar mbi moshën 75 vjeç.

Përfitues të pensionit të pleqërisë janë 49 të moshuar dhe 6 të moshuar trajtohen nga qendra në mungesë të pensionit të pleqërisë.

Pjesa më e madhe e të moshuarve janë me probleme shëndetësore, 25 të moshuar vuajnë nga sëmundje të ndryshme kronike, 19 të moshuar me probleme të shëndetit mendor dhe 5 janë me probleme të rënda shëndetësore, të cilët nuk janë në gjendje të kryejnë vetë shërbimet e tyre. Kartelat individuale për gjithësecilin administrohen nga mjeku i familjes dhe mjekja pranë institucionit, që është e punësuar me kohë të pjesshme.

Spitali Rajonal Memorial Fier kishte ofruar “Check up” në Nëntor 2022 për të gjithë të moshuarit, si dhe nga ana e Spitalit Rajonal Fier ofrohej shërbim për të moshuarit e kësaj qendre.

Gjendja e sigurimit të medikamenteve me të cilat trajtoheshin të moshuarit vazhdonte të ishte e njëjtë, të gjitha medikamentet e nevojshme ishin të rimbursueshme dhe nuk kishte probleme me marrjen e tyre, ndërsa pjesa tjetër e medikamenteve që nuk ishin të rimbursueshme, mbuloheshin me fondet e vetë institucionit. Në ambientet e infermierisë u kontrolluan dhe sasia e ilaçeve që ishte në dispozicion, të cilat ishin brenda afatit të skadencës.

### **Burimet njerëzore**

Struktura e përcaktuar e personelit të këtij institucioni rezidencial përbëhet nga 24 punonjës nga të cilët janë me kohë të plotë 20 punonjës dhe me kohë të pjesshme 4 punonjës përkatësisht: 1 (një) mjek, 1 (një) sanitare dhe 2 (dy) Infermiere.

---

<sup>1</sup> Miratuar me shkresë të Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier, datë 21.01.2019.

Gjatë turnit të parë punojnë 1(një) kujdestare (infermiere) dhe 6(gjashtë) sanitare dhe 1(një) roje. Gjatë turnit të dytë punojnë 1(një) kujdestare 1(një) sanitare dhe 1(një) roje. Gjatë turnit të tretë punon vetëm 1 (një) kujdestare.

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale. Shërbimet shoqërore ofrohen nga 5 kujdestarë me kohë të plotë dhe 2 (dy) infermiere me kohë të pjesshme.

Shërbimi dentar realizohet individualisht, nga vetë të moshuarit, me shpenzimet e tyre dhe jo me fondet e institucionit.

Vlerësimi i punës së stafit bëhet 2 herë në vit nga drejtuesja e institucionit dhe një kopje dërgohet në Bashkinë Fier.

Nga bisedat me të moshuarit tregohet për përkushtimin e stafit për të ndihmuar dhe ofruar shërbime, si dhe gadishmëria e tyre për të plotësuar dhe nevojat e të moshuarve të cilët nuk kanë të afërm apo familjarë.

### **Ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve në Fier**

Shtëpia e të Moshuarve në Fier ndodhet në një godinë dy katëshe. Në katin e parë të kësaj godine gjenden dhomat, ku ishin sistemuar të moshuar meshkuj me probleme shëndetësore, zyrat e administratës dhe mensa. Në katin e dytë gjenden dhoma fjetjeje ku ishin të sistemuara të moshuara gra, si dhe salla e aktiviteteve.

Dhomat e grave ishin shumë të vogla, ku ishin sistemuar 3 të moshuara në çdo dhomë dhe pa tualete në dhomë. Nga ana e zonjave të moshuara, u paraqiten ankesa për hapësirat e dhomave dhe për tualetet. Për 18 të moshuara në qendër egzistojnë vetëm 2 tualete të përbashkëta në korridor dhe kjo përbënte problem si për përdorimin e dusheve, ashtu edhe për përdorimin e tualeteve, duke pasur vështirësi kryesisht gjatë orarit të natës.

Ambientet e këtij institucioni në katin e parë ku qëndronin të moshuar meshkuj, ishin në kushte shumë të këqija, me lagështirë dhe pa ndriçim. Arredimi ishte i amortizuar, por gjithësesi binte në sy që ambienti ishte i pastër dhe shtretërit ishin të rregullt me çarçaf e batanije të pastra.

Gjithashtu tualetet e katit të parë ishin të amortizuara dhe gjithë lagështirë.

Mungesa e një mjedisi terapeutik për të moshuarit e kësaj qendre e bën dhe më të vështirë punën për stafin e kësaj qendre dhe në këto kushte të moshuarit që janë me sëmundjen të rënda rrinë 24 orë vetëm në dhomat e paajrossura dhe me lagështirë.

Godina në të cilën strehohen të moshuarit në Fier **ka nevojë urgjente** për rikonstruksion dhe duhet të shikohet mundësia për shtesë të ambienteve dhe dhomave në mënyrë që të moshuarit të kenë mundësi të banojnë në dhoma me hapësira dhe kushte sipas standardeve.

Në një ambient të veçantë ishin të afishuara rregulloret e jetës së brendshme, standardet që duhet të respektojnë punonjësit e këtij institucioni, si dhe ishte vendosur edhe “kutia e ankesave”, ku depozitoheshin ankesat e të moshuarve. “Kutia e ankesave” hapej një herë në muaj, nga punonjësi social i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier në praninë e një të moshuari.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të veçanta në korridore sipas standardeve. Kolaudimi i tyre bëhet 1 herë në vit. Stafi ishte trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit.

Nga ana e Drejtores së qendrës, znj. Dorina Gjino u informuam, pas rënies së zjarrit në ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve Fier në datë 29 nëntor, se janë përdorur nga Kujdestari i turnit, 4 (katër) mjete kundër zjarrit të vendosura në korridore, për të shuar zjarrin që përfshiu depon e mbajtjes së veglave dhe që shkaktoi tymë e si pasojë u asfiksuan disa të moshuar që u transportuan në Spitalin Rajonal Fier.

Sistemi i ngrohjes realizohej me kaldajë dhe funksiononte.

Gjatë inspektimit, nuk u paraqiten probleme për furnizimin me artikujt hotelerie. Ky furnizim përgjithësisht realizohej nga fondet e institucionit si dhe nga donacione të ndryshme.

Ambienti i kuzhinës ishte i pastër, i pajisur me soba profesionale, frigorifer etj. Kampionët e ushqimeve për të treja vaktet ruheshin në frigorifer.

Kuota ushqimore nga 360 lekë në ditë në ditën e inspektimit, është rritur në vlerën 430 lekë, sipas udhëzimit nr. 662, datë 06.12.2022, “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 689, datë 02.10.2018, për nivelin e kuatove të shpenzimeve për ushqime, në Institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”, bazuar dhe në rekomandimet e njëpasnjëshme të Avokatit të Popullit.

Për përcaktimin e menysë dhe oraret e vakteve të ngrënies, merrej mendimi i të moshuarve. Menyja javore firmoset nga një i moshuar, e cila mund edhe të ndryshohet po nga të moshuarit sipas preferencave. Një herë në vit plotësohet pyetësori për ndryshimin e menysë dhe merret mendimi i tyre. Me qëllim përmbushjen e kërkesave dietike individuale dhe kërkesave ushqimore të moshës, Avokati i Popullit vlerëson marrjen e mendimit të të moshuarve për përcaktimin e menysë, më shpesh se një herë në vit.

Gjatë inspektimit u zhvilluan biseda me të moshuarit, pa praninë e stafit.

### **Jeta social-kulturore**

Përsa i përket jetës sociale, u informuam që organizoheshin aktivitete të ndryshme: ditëlindje, festa fetare, festat zyrtare, si dhe udhëtime të shkurtra.

Në sallën e aktiviteteve, është e vendosur një bibliotekë, televizor, ku të moshuarit kalojnë një pjesë të kohës në shoqëri të njeri-tjetrit, me lojëra dhe aktivitete.

Në ambientin e jashtëm të godinës, ka lulishte dhe oborr të pajisur me stola, ka hapësira të mjaftueshme për shëtitje dhe zbavitje për të moshuarit.

Të moshuarit vizitohen nga të afërmit e tyre. Takimet e realizuara pasqyrohen në një regjistër të veçantë. Për të moshuarit që nuk kanë kontakte me të afërm, bëhet një punë e madhe nga stafi për të bërë të mundur kontaktimin e tyre.

Nuk u paraqitën ankesa ndaj stafit. Ata konfirmonin gatishmërinë e stafit për të plotësuar çdo kërkesë të tyre.

### **Problematikat e konstatuara:**

- Konstatohet se, godina në tërësi ka nevojë urgjente për rikonstrukcion. Ambientet e brendshme dhe banjat e godinës kanë nevojë për restaurim dhe për eliminimin e lagështisë. Ka nevojë imediate për shtesë të hapësirave, të dhomave dhe të banjave për të moshuarit e kësaj qendre, në mënyrë që të krijohen kushte të përshtatshme jetese dhe të ofrohen shërbimet e duhura.
- Konstatohet se, në qendër janë të akomoduar të moshuar që janë me probleme të rënda shëndetësore dhe që nuk kryejnë dot vetëshërbimet, si rrjedhojë del e domosdoshme nevoja për të krijuar një ambient terapeutik, i cili do mund të përdoret jo vetëm për kategorinë e të sëmurëve, por edhe për të moshuarit e tjerë. Sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, për aktivitetin fizik të të moshuarve mbi moshën 65 vjeç, “çdo aktivitet fizik vlen sado i vogël që të jetë”, do të ishte e nevojshme punësimi i një fizioterapisti në këtë qendër.
- Konstatohet se, disa nga rekomandimet e lëna nga Avokati i Popullit, për shtesë me punonjës të specializuar, janë ende të pazbatuara plotësisht, gjë e cila ka sjellë vështirësi në menaxhimin e punës dhe për rrjedhojë mungesë në ofrimin e shërbimeve për të moshuarit.

Për sa më sipër, për të plotësuar standardet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit në institucionet rezidenciale, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive,



## **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave sa më parë për përmirësimin e kushteve të jetesës për të moshuarit, duke bërë të mundur rikonstruksionin e plote me shtesë të një kati të godinës.
2. Marrjen e masave për krijimin e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore.
3. Marrjen e masave për shtim të stafit të specializuar, mjek me kohë të plotë, fizioterapist dhe psikolog.
4. Marrjen e masave deri në rikonstruksionin e plotë të godinës, për zgjidhjen e kapacitetit dhe aksesit në tualete për të akomoduarit në katin e dytë.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Ahmet PRENÇI**

Konceptoi: Lindita Dedëgjoni